



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.8.Regj.Them.**

**Nr.8.VENDIMI**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur në sallën “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtar: Asim VOKSHI** (*Kryesues seance*)

**Gjyqtare: Edlira PETRI** (*Anëtare*)

**Gjyqtare: Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)

**Gjyqtar: Gentjan MEDJA** (*Anëtar*)

**Gjyqtare: Esmeralda XHILI (ÇEKA)** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 19.04.2021, mbaroi së shqyrtuari në seancë gjyqësore, çështjen zgjedhore me nr.8.akti që i përket:

**Paditës:** Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), përfaqësuar në gjykim nga av. Shkëlqim Sulo.

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizim juristi Olsi Peto.

**Person i tretë:** Subjekti Zgjedhor, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), përfaqësuar në gjykim me autorizim nga av. Altin Kaziaj.

**Objekti:**

1. Kundërshtimin dhe ndryshimin e vendimit nr.193 datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë Anëtarin e Tretë dhe të Katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për Zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021”.
2. Kundërshtimin dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve

(KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nr. 20, datë 06.04.2021 i dhënë nga pala e paditur, si një akt, në kundërshtim të plotë me ligjin, faktin dhe të vërtetën.

3. Detyrimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të marrë Vendimin për caktimin e Partisë Politike PDIU-së të marrë pjesë në caktimin e shortit për propozimin e Anëtarit të katërt të GNV-së për Zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021.

**Baza Ligjore:** Nenet 124, 145, 152, 153 dhe 158 pika “b” dhe “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar. Nenet 31, 32/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur dhe personit të tretë që kërkuan rrëzimin e padisë,

### **VËREN:**

1. Se paditësi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 09.04.2021, duke kërkuar kundërshtimin dhe ndryshimin e vendimit nr.193 datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë Anëtarin e Tretë dhe të Katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për Zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021”; kundërshtimin dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nr. 20, datë 06.04.2021 i dhënë nga pala e paditur, si një akt, në kundërshtim të plotë me ligjin, faktin dhe të vërtetën; detyrimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të marrë Vendimin për caktimin e Partisë Politike PDIU-së të marrë pjesë në caktimin e shortit për propozimin e Anëtarit të katërt të GNV-së për Zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021. Gjykimi i kësaj çështjeje u realizuar brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 157(1) të Kodit Zgjedhor.

#### **I. FAKTET E ÇËSHTJES**

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin

3. Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumëëmërore në KQZ, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), 10 (dhjetë) parti politike, dhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.

4. Me vendimin nr. 107, datë 2.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD - PR - PDIU - PAA - PBDNJ - PDK - LZHK - PLL - FRD - BLD - PBKD - PBD - PKD)” është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Paditësi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) rezulton të jetë pjesë e këtij koalicioni. Në marrëveshjen për krijimin e Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në pikën 4 të saj përcaktohet se: *“Autorizohet Z. Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike që të paraqese pranë KQZ listat shumëëmërore të kandidatëve për deputet si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve deri në përfundim të procesit zgjedhor”*. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se: *“Autorizon z. Ivi Kaso që, të paraqesë kërkesë për regjistrimin e koalicionit së bashku me këtë marrëveshje në KQZ; të përfaqësojë koalicionin gjatë procesit të shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit; të caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KZAZ, KQV dhe në VNV në të gjithë vendin”*.

5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) në zbatim të nenit 95, paragrafi 2 dhe nenit 96, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve nr.5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 193, datë 31.03.2021, në përfundim të procesit ka vendosur:

“1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.”

7. Në lidhje me këtë vendimmarrje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka arsyetuar se:

“Partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve, respektivisht Partia Socialiste

dhe Partia Demokratike, nuk renditen në listën e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve;

Parti politike që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, jo më pak se dy mandate, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, janë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, si subjekt zgjedhor është anëtare/pjesëtare e koalicionit PD-AN dhe nuk ka paraqitur listë shumëemërore të vetën.

Bazuar në nenin 65, paragrafi 3, të Kodit Zgjedhor, përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit, si dhe marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet në KQZ.

Për këto arsye, referuar nenit 2, paragrafët 2 dhe 3, të Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”:

- Nga partitë politike të shumicës parlamentare, Partia Socialdemokrate nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve për të qënë pjesë e shortit në caktimin e anëtarit të tretë të GNV-ve. Partia Socialiste e Shqipërisë është e vetmja parti e cila plotëson kriterin e numrit të mandateve nga partitë e shumicës parlamentare, për të propozuar anëtarin e tretë të GNV-ve.
- Nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim përmbush kriterin e numrit të mandateve, dhe i lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, si parti e koalicionit zgjedhor PD-AN nuk legjitimohet të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve, për arsye se të drejtat e tij si subjekt janë përmbushur nga partia udhëheqëse e koalicionit (Partia Demokratike).”

8. Paditësi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) është ankimuar ndaj vendimit të sipërcituar, pranë KAS duke kërkuar: *“Ndryshimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe caktimin e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet për të marrë pjesë në shortin për anëtarin e katërt të GNV-së”*. Subjekti Politik Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, ka pretenduar se argumenti mbi të cilin u mbështet Komisioneri në vendimin e tij që PDIU nuk ka të drejtën e propozimit të numëruesit, sepse është pjesë e koalicionit, është i gabuar, pasi në marrëveshjen e koalicionit PD-AN në asnjë rast nuk është shënuar ndonjë detyrim për tu shmangur nga e drejta që kanë si parti parlamentare e opozitës me më shumë se dy mandate për të caktuar një anëtar të GNV-së. Vendimi nr. 193/2021 i KSHZ-së nuk është në përputhje me nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe

parimin e baraspeshimit politik në përbërjen e Grupeve të Numërimit të Votave.

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 20, datë 05.04.2021, ka vendosur:

*“1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.11, datë 02.04.2021 të subjektit ankues Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;*

*2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.*

10. Në marrjen e këtij vendimi Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ ka arsyetuar si vijon:

1. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Kryetar z. Shpëtim Idrizi, me vendimin, nr. 33, datë 05.02.2021. Në datën 24.02.2021, PDIU, bashkë me njëmbëdhjetë parti politike të tjera të regjistruara pranë KQZ-së, kanë kërkuar regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” (PD-AN) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur kësaj kërkesë është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit ku partitë pjesëmarrëse kanë shprehur vullnetin e tyre për të qenë pjesë e këtij koalicioni dhe ndër të tjera kanë caktuar Partinë Demokratike si parti udhëheqëse të koalicionit, referuar nenit 65, paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar.

2. Në momentin e regjistrimit të koalicionit PD-AN, me vendimin e KSHZ-së nr. 107, datë, 02.03.2021 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD- PBD-PKD), “PD-AN, për “zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, subjekti ankues PDIU nuk mund të konsiderohet më në cilësinë e subjektit zgjedhor, duke qenë se këtë status tashmë e ka fituar koalicioni në të cilin PDIU bën pjesë. Ky argument përforcohet me faktin se PDIU nuk ka depozituar një listë të vetën shumemërore, nuk përfshihet në fletën e votimit me emrin dhe siglën e saj si parti më vete, por gjithmonë si pjesë e koalicionit PD-AN.

3. KAS vëren se sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor, regjistrimi i PDIU-së si koalicion zgjedhor së bashku me partitë e tjera, sjell si pasojë humbjen e së drejtës për të marrë pjesë në koalicion tjetër përveç atij ku është regjistruar, dhe gjithashtu humbjen e të drejtës për të paraqitur kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor me anë të ligjit nr. 118, datë 05.10.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i

ndryshuar”, në nenin 65 është shtuar pika e tretë, e cila parashikon se në momentin e regjistrimit të një koalicioni zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që përcaktohen nga Kodi Zgjedhor për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

4. Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje.

5. Me vendimin nr.10, datë 06.06.2019, Kolegji Zgjedhor ka vendosur rrëzimin e padive të palëve paditëse PD dhe LSI, për shkak se nuk konsideroheshin subjekte zgjedhore. Interpretimi që Kolegji i bën termit “subjekt zgjedhor” në këtë vendim, është i tillë që përfshin: *“ata subjekte të cilët në funksion të realizimit të programit të tyre, si dhe të prezantimit të pikëpamjeve të veta, është parashikuar të paraqesin edhe listat shumemërore të kandidatëve. (...) Pra është e dukshme se dy subjektet politike PD dhe LSI, përsa nuk kanë paraqitur listë kandidatësh, nuk kanë cilësinë e subjektit zgjedhor.”*

Në analogji me çështjen në fjalë, as PDIU nuk mund të konsiderohet subjekt zgjedhor sipas interpretimit të Kolegjit Zgjedhor, sepse nuk ka depozituar lista të vetat shumemërore. Për më tepër, nëse i referohemi listave shumemërore që subjekti zgjedhor PD - AN ka depozituar në KQZ, kandidatë nga PDIU ka vetëm në 5 nga 12 zonat zgjedhore, më konkretisht në Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë dhe Vlorë, çka do të thotë që në 7 zona të tjera zgjedhore, PDIU si parti politike, nuk ka asnjë interes në numërimin e votave çka është dhe kompetenca e GNV-ve. Ndaj interpretimi i KAS shkon dhe në përputhje me frymën e ratio legis të neneve 95 dhe 96 të K.Zgjedhor.

6. Neni 95, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor parashikon se *“GNV-të përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor”*. Më pas, në nenin 96 paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se *“Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike*

*të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.”*

7. Referuar nenit 96 të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimit nr. 5/2021 të KSHZ-së “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, Koinisioneri, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.

8. Vendimi nr. 555, datë 26.07.2017 i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, ku numri i mandateve të fituara është si vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) 74 mandate;
- Partia Demokratike (PD) 43 mandate;
- Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) 19 mandate;
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) 3 mandate;
- Partia Social Demokrate e Shqipërisë (PSD) 1 mandat;

Mbështetur në rezultatin e mësipërm, KSHZ ka vendosur në vendimin nr. 193/2021 se partitë politike që kanë të drejtën e propozimit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-ve janë PS dhe PD, dhe si të tilla këto parti nuk renditen në listën e partive që do të propozojë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve. Nga partitë e shumicës, PSD nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve, prandaj është PS që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve; ndërkohë që nga partitë e opozitës është LSI që ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve.

9. Në rastin konkret, duke marrë parasysh se në marrëveshjen e koalicionit të depozituar pranë KQZ-së nga partitë pjesëmarrëse të koalicionit PD-AN, në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje, është përcaktuar si parti udhëheqëse Partia Demokratike, automatikisht të gjitha të drejtat e rezervuara për partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni do të ushtrohen vetëm nga kjo parti udhëheqëse. Ndër këto të drejta, përfshihet edhe e drejta për të marrë pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve. Duke marrë parasysh se PD është partia që propozon nënkryetarin e KZAZ-ve, ajo ka të drejtën e propozimit të numëruesit të dytë të GNV-ve.

10. Bazuar në nenin 96, pika 1/1 të Kodit Zgjedhor: “nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda

të njëjtit grupim politik”. Pra, hipotetakisht, edhe nëse PDIU do të pretendonte që e drejta e propozimit të anëtarit të katërt ti kalonte PD-së si parti udhëheqëse e koalicionit, kjo gjë do të ndodhte vetëm nëse asnjë nga partitë e tjera të opozitës nuk do të përmbushnin kriterin e numrit të mandateve, por në rastin konkret, nga partitë e opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, LSI i përmbush kriteret e nenit 96, prandaj e drejta e propozimit të anëtarit të katërt kalon automatikisht te LSI.

11. KAS i gjen me vend parashtrimet e palës së interesuar, LSI, kur shprehet se PDIU nëpërmjet përfshirjes në koalicionin PD-AN, ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesëmarrëse duke deleguar të drejtat që mund ti ushtronte vetë kryesuesit të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj në fletën e votimit, si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh për 12 qarqet, është tregues i qartë për tu marrë në konsideratë lidhur me faktin që PDIU që nga momenti i përfshirjes në një koalicion e ka humbur statusin e subjektit zgjedhor si dhe legjitimitimin e saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Tashmë subjekt zgjedhor është koalicioni PD - AN që ka depozituar listat shumëmemërore, pjesë e të cilave janë dhe kandidatë nga PDIU.

12. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se në marrëveshjen e koalicionit nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur e drejta e partisë udhëheqëse për të marrë pjesë në short për caktimin e anëtarëve të GNV-ve, KAS arsyeton se marrëveshja e lidhur mes 12 partive pjesëmarrëse të koalicionit është një kontratë që sjell të drejta dhe detyrime për palët sipas vullnetit të tyre, por nuk mund të dalë kurrësi jashtë kornizës ligjore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Disa nga detyrimet që kjo kornizë ligjore përcakton janë: caktimi i një partie udhëheqëse; pjesëmarrja në zgjedhje nën emrin dhe logon e koalicionit dhe jo si parti më vete; depozitimi i listave shumëmemërore nga koalicioni dhe jo nga partitë më vete, etj.

13. Fjalja e dytë e pikës 3 të nenit 65 të K.Zgjedhor ku parashikohet se “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” është shtruese sa i përket të gjitha të drejtave që subjektet zgjedhore gëzojnë. Fakti që ligjvënësi nuk e ka ndryshuar nenin 96 të K.Zgjedhor në lidhje me të drejtën e partive për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, por ndërkohë, përjashtimisht për partitë politike pjesëtare të një koalicioni subjekt zgjedhor, ka ndryshuar pikën 3 të nenit 88 të K.Zgjedhor, që tashmë parashikon se “KQZ-ja përlogarit shumën që i takon secilës parti, dake shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në



koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”, tregon qartë vullnetin e ligjvënësit për veçimin e një të drejte specifike siç është ajo e financimit të partive politike.”

11. Pala paditëse Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), pasi është bërë me dije të vendimit të KAS, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padinë objekt gjykimi. Konkretisht partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka ngritur pretendime mbi kundërshtimin e vendimit nr. 193 datë 31.03.2021 të KSHZ dhe vendimit nr. 20, datë 05.04.2021 si vijon:

Vendimet e ankimuarra janë në shkelje flagrante të ligjit e si të tilla duhet të ndryshohen duke vendosur pranimin e padisë. Me vendimin nr. 107, datë 2.3.2021, të KSHZ, Subjekti Zgjedhor, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) rezulton të jetë pjesë e Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD□PBKD-PBD-PKD)” e cila është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

KQZ me vendimin nr.555, datë 26.07.2017, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017, numri i mandateve të fituara është PS - 76, PD - 43, LSI - 19; PDIU - 3 dhe PSD – 1 mandate.

Nenet 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, konkretisht në nenin 96, paragrafi 1, parashikon se partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.

Në parlamentin e Shqipërisë të dalë nga zgjedhjet e vitit 2017, është votuar ndryshimi i Kodit Zgjedhor mbi bazën e së cilit do të zhvillohen zgjedhjet e para parlamentare dhe ato vendore, dhe është rënë dakort midis të tjerave edhe mbi disa çështje, të cilat do të rregulloheshin, me anë të dispozitave kalimtare, siç janë përcaktuar konkretisht në nenin 183 të këtij Kodi, me titull “Formimi kalimtar i organeve drejtuese dhe i administratës zgjedhore” në piken 8 citohet konkretisht: “Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve

të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.”

Është i pabazuar argumenti mbi të cilin u mbështet Komisioneri, që subjekti zgjedhor i PDIU-së, është pjesë e koalicionit dhe ai tashmë, nuk ka të drejtën e propozimit të numëruesit sipas Kodit Zgjedhor. Në lidhje me këtë pretendim subjekti i referohet nenit 65 “Regjistrimi i koalicioneve”, të Kodit Zgjedhor në të cilin përcaktohet hartimi i Marrëveshjes së Koalicionit. Nga përmbajtja e marrëveshjes së depozituar në KQZ, mbi krijimin e koalicionit, nuk rezulton të ketë asnjë përcaktim se subjekti politik PDIU nuk i takon e drejta e propozimit të një anëtarit të GNV-së. Gjithashtu subjekti politik PDIU, nuk mund të shmanget nga e drejta e gëzimit të disa hapësirave që na garanton ligji i Kodit Zgjedhor.

Për analogji subjekti i referohet vendimit të datës 12.06.2017, për rezultatin e zgjedhjeve të 2017, ku LSI dhe PDIU ishin në shumicë parlamentare dhe Republikanët ishin në opozitë, por që kishin fituar më shumë se 2 mandate dhe ato ishin pjesë e shortit.

Në mbështetje të Kodit Zgjedhor në nenin 116, theksohet se numërimi i votave në zgjedhje bëhet nga grupet e numërimit të votave (GNV), të cilat përbëhen nga katër anëtarë. Anëtarësia në grupin e numërimit është detyrë publike, e cila ushtrohet në emër të ligjit. Rrethi i detyrave të anëtarit të GNV-SQ, mënyra e emërimit, procedurat, afatet, përfitimet, disiplina dhe llogaridhënia janë përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ngritja e GNV-ve bëhet në bashkëveprim me partitë politike që gëzojnë të drejtën e propozimit të kandidaturave për anëtarë të GNV-ve, bazuar në parimin e barazpeshimit politik (dy anëtarë nga shumica, dy anëtarë nga opozita parlamentare), por anëtarët e GNV-ve nuk janë në detyrë për të numëruar votat e partive që i propozojnë. Ata nuk janë në detyrë me tagra përfaqësimi, sikurse interpretohet rëndom, por si administratorë zgjedhorë. Nëse prezenca lexohet si përfaqësim, atëherë ata përfaqësojnë në gjysmën e tyre gjithë shumicën parlamentare dhe në gjysmën tjetër gjithë opozitën parlamentare.

Që një parti politike të mund të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidatura për anëtarë të GNV-ve duhet të plotësojë këto kushte dhe kritere: të jetë parti parlamentare; të jetë regjistruar në zgjedhje; të ketë fituar jo më pak se dy mandate parlamentare, kushte që subjekti politik PDIU, i plotëson.

Në vijim të argumentave pala paditëse ka kryer një përshkrim të mendimit të pakicës së vendimit nr. 20, datë 05.04.2016 të KAS, sipas së cilës veç të tjerash argumentohet se në bazë të nenit tranzitor 183, paragrafi i fundit të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 95 dhe 96 të KZ, partitë politike që legjitimohen për propozimin e kandidaturave për anëtarë të GNV-ve janë Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD), Lëvizja Socialiste për

Integrim (LSI) dhe Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU). Për shkak se PD, LSI dhe PDIU duhet të ndajnë propozimet për dy vende në GNV, Kodi kërkon që për vendin e katër të hidhet short midis LSI-së dhe PDIU-së.

12. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar të njëjtat shkaqe mbi rrëzimin e padisë, sikurse është arsyetuar në vendimin nr. 20, datë 06.04.2021 të KAS. Sipas kësaj pale kërkesimet e palës paditëse, janë të pabazuar në ligj dhe në prova, si rrjedhojë kërkohet lënia në fuqi e vendimeve objekt gjykimi.

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë KQZ me Kryetar z. Shpëtim Idrizi, me vendimin, nr. 33, datë 05.02.2021.

Në momentin e regjistrimit të koalicionit PD-AN, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 02.03.2021, subjekti ankues PDIU nuk mund të konsiderohet më në cilësinë e subjektit zgjedhor, duke qenë se këtë status tashmë e ka fituar koalicioni në të cilin PDIU bën pjesë. Ky argument përforcohet me faktin se PDIU nuk ka depozituar një listë të vetën shumemërore, nuk përfshihet në fletën e votimit me emrin dhe siglën e saj si parti më vete, por gjithmonë si pjesë e koalicionit PD-AN.

Në zbatim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, regjistrimi i PDIU-së si koalicion zgjedhor së bashku me partitë e tjera, sjell si pasojë humbjen e së drejtës për të marrë pjesë në koalicion tjetër përveç atij ku është regjistruar, dhe gjithashtu humbjen e të drejtës për të paraqitur kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor në nenin 65 është shtuar pika 3, e cila parashikon se në momentin e regjistrimit të një koalicioni zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që përcaktohen nga Kodi Zgjedhor për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”.

Për analogji KQZ i referohet një vendimi të marrë nga Kolegji Zgjedhor, vendimi nr. 10, datë 06.06.2019, me të cilin është vendosur rrëzimi i padive të palëve paditëse PD dhe LSI, për shkak se nuk konsideroheshin subjekte zgjedhore. Interpretimi që Kolegji i bën termit “subjekt zgjedhor” në këtë vendim, është i tillë që përfshin: *“ata subjekte të cilët në funksion të realizimit të programit të tyre, si dhe të prezantimit të pikëpamjeve të veta, është parashikuar të paraqesin edhe listat shumemërore të kandidatëve. (...) Pra është e dukshme se dy subjektet politike PD dhe LSI, për sa nuk kanë paraqitur listë kandidatësh, nuk kanë cilësinë e subjektit zgjedhor”*.

Në rastin konkret PDIU nuk mund të konsiderohet subjekt zgjedhor sipas interpretimit të Kolegjit Zgjedhor, sepse nuk ka depozituar lista të vetat shumemërore.

Për më tepër, nëse i referohemi listave shumëemërore që subjekti zgjedhor PD – AN ka depozituar në KQZ, kandidatë nga PDIU ka vetëm në 5 nga 12 zonat zgjedhore, më konkretisht në Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë dhe Vlorë, çka do të thotë që në 7 zona të tjera zgjedhore, PDIU si parti politike, nuk ka asnjë interes në numërimin e votave çka është dhe kompetenca e GNV-ve.

Referuar nenit 96 të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimit nr. 5/2021 të KSHZ-së “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, Komisioneri, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.

Vendimi nr. 555, datë 26.07.2017 i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, ku numri i mandateve të fituara është si vijon: Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) 74 mandate; Partia Demokratike (PD) 43 mandate; Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) 19 mandate; Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) 3 mandate; Partia Social Demokrate e Shqipërisë (PSD) 1 mandate. Mbështetur në rezultatin e mësipërm, KSHZ ka vendosur në vendimin nr. 193/2021 se partitë politike që kanë të drejtën e propozimit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-ve janë PS dhe PD, dhe si të tilla këto parti nuk renditen në listën e partive që do të propozojë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve. Nga partitë e shumicës, PSD nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve, prandaj është PS që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve; ndërkohë që nga partitë e opozitës është LSI që ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve.

Në rastin konkret, duke marrë parasysh se në marrëveshjen e koalicionit të depozituar pranë KQZ-së nga partitë pjesëmarrëse të koalicionit PD-AN, në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje, është përcaktuar si parti udhëheqëse Partia Demokratike, automatikisht të gjitha të drejtat e rezervuara për partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni do të ushtrohen vetëm nga kjo parti udhëheqëse. Ndër këto të drejta, përfshihet edhe e drejta për të marrë pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve. Duke marrë parasysh se PD është partia që propozon nënkryetarin e KZAZ-ve, ajo ka të drejtën e propozimit të numëruesit të dytë të GNV-ve.

Bazuar në nenin 96, pika 1/1 të Kodit Zgjedhor: “*nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik*”. Pra, hipotetikisht, edhe nëse PDIU do të pretendonte që e drejta e propozimit të anëtarit të katërt ti

kalonte PD-së si parti udhëheqëse e koalicionit, kjo gjë do të ndodhte vetëm nëse asnjë nga partitë e tjera të opozitës nuk do të përmbushnin kriterin e numrit të mandateve, por në rastin konkret, nga partitë e opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, LSI i përmbush kriteret e nenit 96, prandaj e drejta e propozimit të anëtarit të katërt kalon automatikisht te LSI.

PDIU nëpërmjet përfshirjes në koalicionin PD - AN, ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesëmarrëse duke deleguar të drejtat që mund ti ushtronte vetë kryesuesit të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj në fletën e votimit, si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh për 12 qarqet, është tregues i qartë për tu marrë në konsideratë lidhur me faktin që PDIU që nga momenti i përfshirjes në një koalicion e ka humbur statusin e subjektit zgjedhor si dhe legjitimitimin e saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Tashmë subjekt zgjedhor është Koalicionin PD – AN që ka depozituar listat shumëmemërore, pjesë e të cilave janë dhe kandidatë nga PDIU.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se në marrëveshjen e koalicionit nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur e drejta e partisë udhëheqëse për të marrë pjesë në short për caktimin e anëtarëve të GNV-ve, ne arsyetojmë se marrëveshja e lidhur mes 12 partive pjesëmarrëse të koalicionit është një kontratë që sjell të drejta dhe detyrime për palët sipas vullnetit të tyre, por nuk mund të dalë kurrësi jashtë kornizës ligjore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Disa nga detyrimet që kjo kornizë ligjore përcakton janë: caktimi i një partie udhëheqëse; pjesëmarrja në zgjedhje nën emrin dhe logon e koalicionit dhe jo si parti më vete; depozitimi i listave shumëmemërore nga koalicioni dhe jo nga partitë më vete, etj.

Fjala e dytë e pikës 3 të nenit 65 të K. Zgjedhor ku parashikohet se *“Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”* është shteruese sa i përket të gjitha të drejtave që subjektet zgjedhore gëzojnë. Fakti që ligjvënësi nuk e ka ndryshuar nenin 96 të K. Zgjedhor në lidhje me të drejtën e partive për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, por ndërkohë, përjashtimisht për partitë politike pjesëtare të një koalicioni subjekt zgjedhor, ka ndryshuar pikën 3 të nenit 88 të K. Zgjedhor, që tashmë parashikon se *“KQZ-ja përllogarit shumëmemërore që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”*, tregon qartë vullnetin e ligjvënësit për veçimin e

një të drejte specifike siç është ajo e financimit të partive politike.

Për këtë shkak, konsiderohet se partitë pjesëmarrëse në koalicion, përfshirë PDIU, në momentin e përcaktimit të partisë udhëheqëse të koalicionit PD-AN, si detyrim që buron nga paragrafi 3 i nenit 65 të Kodit Zgjedhor, rrjedhimisht kanë pranuar të delegojnë këto të drejta dhe detyrime.

12. Personi i tretë Subjekti Zgjedhor, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar shkaqe mbi rrëzimin e padisë, dhe lënien në fuqi të vendimeve të KSHZ të KAS, objekt gjykimi. Ata pretenduan kryesisht se:

Lëvizja Socialiste për Integrim është forca e tretë më e madhe në vend, me 19 mandate sipas konstituimit të Kuvendit në zgjedhjet e 2017. Ky subjekt zgjedhor është regjistruar i vetëm, duke depozituar listat mbështetëse sipas nenit 68 të Kodit Zgjedhor dhe listat e kandidatëve nën siglën LSI.

PDIU me Vendim 107 datë 2 mars 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është regjistruar si pjesë e koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHKPLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” për zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021, me Udhëheqës subjektin zgjedhor Partia Demokratike. Në kushtet kur paditësi është pjesë e koalicionit zgjedhor nga ana e tij nuk është dorëzuar një listë kandidatësh si subjekt sipas parashikimeve të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, dhe dokumentat e kandidatit sipas nenit 72 pika 1 dhe 2 të po këtij Kodi.

Në momentin që një subjekt regjistrohet si koalicion me një ose disa subjekte të tjera dhe koalicioni drejtohet nga një parti tjetër udhëheqëse, subjekti e humb legjitimitetin për të vepruar në emër dhe për interes të vetë, dhe ky legjitimitet kalon, pra delegohet në cilësinë juridike të mbrojtjes të të drejtave dhe detyrimeve, partisë udhëheqëse të koalicionit.

Ligjvënësi në nenin 65 të Kodit Zgjedhor veç të tjerash përcakton se: *“Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ. Me shkresën nr.1482 prot., datë 24.02.2021, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e koalicionit “PD-AN”, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese Partia Demokratike kërkohet regjistrimi i koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRDBLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN”, si subjekt zgjedhor për Kuvend e datës të 25 Prill 2021. Bashkëlidhur kërkesës për regjistrim është depozituar*

edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni. Marrëveshja përmban: 1. *Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit*; 2. *Formimin e koalicionit me emrin “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”*; 3. *Shkronjat nistore të koalicionit “PD-AN”*; 4. *Sigllën e koalicionit*; 5. *Autorizimin e z. Lulzim Basha kryetar i Partisë Demokratike të dorëzojë listat shumëmemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit*; 6. *Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV*; 7. *Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit*; 8. *Autorizimin e z. Ivi Kaso, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ*;

PDIU nëpërmjet përfshirjes në këtë koalicion, ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesëmarrëse duke deleguar tagrat që mund t'i ushtronte vetë kryesuesit të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj në fletën e votimit si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mos pasja e një liste kandidatësh në 12 qarqe, është tregues i qartë për tu marrë në konsideratë lidhur me mos legjitimitimin e saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Një marrëveshje të tillë ky subjekt do të duhet ta kishte bërë me partinë udhëheqëse dhe jo të kërkonte caktimin e numëruesve nga momenti që elementët identifikues të saj nuk do të rezultojnë në fletën e votimit.

PDIU është regjistruar pranë KQZ si pjesë e një koalicioni zgjedhor me Parti Udhëheqëse Partinë Demokratike, në vijim të këtij arsytimi PDIU gëzon të drejtën e numëruesit të dyte sipas parashikimeve të nenit 96 të Kodit Zgjedhor. Referuar faktit se bazuar në nenin 96, pika 2 subjekti politik PD e gëzon numëruesin, rrjedhimisht rezulton se PDIU e përmbush interesin e saj të ligjshëm lidhur me numërimin e votave.

Sipas parashikimit të nenit 65, paragrafi 3 i Kodit zgjedhor, marrëveshja e nënshkruar midis partive politike pjesë e koalicionit është një akt me karakter deklarativ për KQZ dhe me karakter detyrues për palët e lidhura nga ajo. Një marrëveshje para ose pas elektorale në asnjë rast nuk mund të kapërcej parashikimet eksplicite të një norme ligjore, përkundrazi fryma e saj (e marrëveshjes), dhe përmbajtja duhet të jenë gjithmionë në harmoni me ligjin.

Me ndryshimet e bëra në nenin 65, paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor ligjvënësi ka pasur si qëllim të heq legjitimitimin e një subjekti politik nga momenti që ky i fundit lidhet në marrëveshje koalicioni, duke i deleguar partisë udhëheqëse të këtij koalicioni të drejtat dhe legjitimitetin që subjekti po të ishte regjistruar i vetëm, do ti gëzonte vetë. Pranimi i një subjekti për të lidhur

marrëveshje parazgjedhore me një ose disa parti të tjera, caktimi i partisë udhëheqëse, mospasja e një logoje identifikuese të vetën, mos dorëzimi i listës së kandidatëve sipas qarqeve, automatikisht passjell delegimin e kompetencave dhe legjitimitet të kryesuesi i koalicionit i cili ka logon, emrin e partisë, emrin e kryetarit dhe listën e kandidatëve si dokumentacion detyruar për regjistrim sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Në heshtje kjo është pranuar dhe nga partia drejtuese/udhëheqëse e koalicionit e cila nuk ka pasur kundërshtime mbi vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që PDIU ankimon. Vetëm partia udhëheqëse legjitimohej duke pasur interes të ligjshëm që të kundërshtonte këtë vendimmarrje.

Këto konkluzione dalin në përputhje me parimin e barazpeshimit politik në përbërjen e grupeve të numërimit të votave të cilat japin balancën midis një procesi të drejtë numërimi dhe një të drejte të mbështetur në ligj.

Sa më lart, kërkohet lënia në fuqi e Vendimit Nr. 193, datë 31.03.2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi nr. 20, datë 06.04.2021 i KAS, si të bazuar në ligj dhe në prova.

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

13. Neni 2(20) i Kodit të Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë parashikon se:

*“Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e 3 propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.”*

14. Neni 63(1) i Kodit Zgjedhor parashikon se:

*“1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.”*

15. Neni 65 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

*“1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.*

*2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.*

*3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”*

16. Neni 95 i Kodit Zgjedhor parashikon se:



“1. Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Numri i grupeve të numërimit është dy për çdo tavolinë numërimi, sipas pikës 2 të nenit 94 të këtij Kodi. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e neneve 30 dhe 31 të këtij Kodi. Propozimet për emërimin e anëtarëve duhet të dorëzohen në KZAZ të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi.

Në vendimin për emërimin e Grupit të Numërimit të Votave, KZAZ-ja cakton një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar. Në gjysmën e Grupeve të Numërimit të Votave numëruesi i parë propozohet nga partia më e madhe e shumicës dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Sekretari i Grupit të Numërimit të Votave i përket partisë politike të kundërt me partinë që propozon numëruesin e parë. KQZ-ja me udhëzim përcakton mënyrën e hedhjes së shortit.

3. Në rast se ndonjë nga subjektet zgjedhore nuk paraqet propozime brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, KZAZ-ja cakton me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në rang zone zgjedhore. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

4. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Në përfundim të këtij procesi grupi i numërimit zëvendësohet nga grupi tjetër i numërimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

5. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizimit të punës, ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve.”

17. Neni 96 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.

1/1. Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik.

2. Jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për çdo ZAZ, në prani të partive politike të interesuara. Procedurat për hedhjen e shortit përcaktohen me udhëzim të veçantë të KQZ-së.”

18. Neni 183(8) i Kodit Zgjedhor, sipas ndryshimeve të ligjit nr.101/2020, parashikon se:

“8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.”

### III. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

19. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se padia e paraqitur nga paditësi partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) është e pabazuar në ligj e në prova dhe për këtë shkak duhet rrëzuar.

20. Paditësi PDIU bën një interpretim të gabuar të neneve 63(1), 65(3), 95, 96 dhe 183(8) të Kodit Zgjedhor, e për rrjedhojë kërkimet e tij nuk gjejnë mbështetje ligjore. Kjo pasi, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor thekson se duhen dalluar dy situata qartësisht të ndryshme me njëra-tjetrën, të cilat kanë si parakusht formën e garimit në zgjedhje të një partie politike siç është edhe PDIU. Nëse kjo parti politike do të paraqitej e vetme në zgjedhje, duke paraqitur listën e vet të kandidatëve, atëherë ajo do të gëzonte të plota të gjitha të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor, përfshirë edhe ato sipas neneve 95, 96 e 183(8) të këtij Kodi. PDIU në këtë rast do të paraqitej si subjekt zgjedhor më vete, në kuptim të nenit 63(1) të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë referuar personave juridike që veprojnë si parti politike njeh si subjekte zgjedhore vetëm dy kategori: 1) partinë politike që garon e vetme dhe paraqet po e vetme listë kandidatësh për konkurim në zgjedhje dhe 2) koalicionin e disa partive politike, i cili paraqet listë kandidatësh për garim në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Varësisht formës së futjes në garë të një partie politike (e vetme apo në koalicion), rrjedhin edhe disa kufizime të të drejtave të veta sipas Kodit Zgjedhor, të cilat lidhen edhe me cilësinë si subjekt zgjedhor të partisë politike.

21. Në rastin konkret, neni 65(3) i Kodit Zgjedhor ka përcaktuar shprehimisht se “[p]ër nevojat e zbatimit të këtij ligji, **të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.**” Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë, sipas natyrës së të drejtës që diskutohet. Ky formulim është

shtuar me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020 dhe për rrjedhojë si rregull i miratuar më vonë në kohë, kushtëzon dhe përcakton kuptimin e dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat krijojnë përplasje me të. Duke qenë se në rastin konkret, subjekt zgjedhor garues në zgjedhje është koalicioni PD-AN, këtij i përkasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi parashikon për subjektet zgjedhore, në lidhje me administrimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Ky koalicion përfaqësohet nga Partia Demokratike dhe me të drejtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se meqë PD ishte tashmë e përfshirë në përcaktimin e kryetarit apo nënkryetarit të KZAZ-ve, në zbatim të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, e drejta e propozimit të anëtarit të katërt, duhet t'i kalonte LSI-së. LSI duke mos qenë në koalicion me Partinë Demokratike, në dallim nga PDIU, ka ruajtur për vete të gjitha të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor, në lidhje me fazën e kontributit të subjekteve zgjedhore në administrimin e zgjedhjeve. PDIU në këtë rast, përse i përket të drejtës për propozim të anëtarit të katërt, apo për efekt të përfshirjes në short bashkë me LSI, duke qenë se është përfshirë në koalicionin PD-AN, vlerësohet se barazohet me pozitën e PD *(kjo e fundit përmbush të gjitha të drejtat që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor për subjektin garues në zgjedhje)*, e cila tashmë e ka të drejtën për propozimin e një anëtari të GNV. Kjo do të thotë, se e drejta spostohet tek LSI dhe vetëm nëse kjo e fundit *(si subjekti i vetëm që mbetet e që plotëson kriteret ligjore sipas nenit 96(1) të Kodit Zgjedhor)* zgjedh të mos propozojë anëtarin e katërt të GNV, atëherë në zbatim të nenit 96(1/1) të Kodit Zgjedhor, e drejta i rikthehet PD, e cila vepron si përfaqësuese e koalicionit PD-AN. Në këtë rast hipotetik, PD-ja mund të zgjidhte në marrëveshje me PDIU, që të caktohte konkretisht përfaqësues të kësaj të fundit në të gjitha apo një pjesë të GNV-ve.

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se neni 96 i Kodit Zgjedhor ka mbetur i pandryshuar që nga viti 2012 dhe rregullat e përcaktuara në të, duhet të shihen në dritën e ndryshimeve substanciale që solli ligji nr. 118/2020, datë 5.10.2020, veçanërisht në lidhje me kuptimin e të drejtave të subjekteve garuese në zgjedhje, sipas nenit 65(3) të Kodit Zgjedhor. PDIU nuk mund të veprojë sikur nuk është pjesë e PD-AN, pasi ajo me vullnetin e saj të lirë është bërë pjesë e këtij koalicioni garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Duke u futur në këtë koalicion PDIU ka pranuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin jo vetëm nga marrëveshja e nënshkruar nga të gjitha partitë, por edhe nga efektet që rrjedhin nga zbatimi i arsyeshem i dispozitave të caktuara të Kodit Zgjedhor. Zgjidhja e dhënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është rrjedhojë e zbatimit korrekt të ligjit dhe ndryshe nga sa pretendon paditësi, është kjo zgjidhje që garanton parimin e barazpeshimit politik. Paditësi PDIU nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndonjë short me LSI-në për propozimin e anëtarit të katërt të GNV, pasi siç u tha edhe më sipër, për efekt të zbatimit të nenit 96 të Kodit Zgjedhor *(në vështrim të nenit 65(3) të këtij Kodi)*, pozita e PDIU shkrihet me atë të PD, e cila është partia udhëheqëse e koalicionit PD-

AN, i cili gëzon cilësinë e subjektit zgjedhor garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

23. Gjatë gjykimit rezultoi se PD, si parti udhëheqëse dhe përfaqësuese e koalicionit PD-AN (ku bën pjesë edhe PDIU), nuk ka shfaqur kundërshtime në lidhje me zbatimin që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka bërë nenit 96 të Kodit Zgjedhor. Rrjedhimisht edhe ky fakt bën që të vlerësohet se pretendimet e paditësit PDIU nuk janë të bazuara në ligj e në prova, ndaj me të drejtë nuk janë marrë parasysh as nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe as nga KAS. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i gjen të bazuara zgjidhjet e vendimeve objekt gjykimi të KShZ dhe KAS, e për këtë shkak vlerëson se padia e paditësit PDIU është e pabazuar dhe e pathemeltë, duke passjellë kjo rrëzimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I :**

1. Rrëzimin e padisë së paditësit “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë 19 prill 2021.

#### **ANËTARE**

**Manjola XHAXHO**

#### **ANËTARE**

**Edlira PETRI  
(Kundër)**

#### **KRYESUES**

**Asim VOKSHI**

#### **ANËTARE**

**Esmeralda XHILI (ÇEKA)**

#### **ANËTAR**

**Gentjan MEDJA**

## MENDIM PAKICE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendimin nr. 8, datë 19.04.2021 vendosi të rrëzojë padinë e subjektit zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, duke i gjetur të pabazuara pretendimet, lidhur me caktimin e numëruesit të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave (në vijim, referuar si GMV), për zgjedhjet për Kuvendin, që do të zhvillohen në datë 25.04.2021.

Si anëtare e këtij Kolegji, ndaj mendim të kundërt me atë të shumicës, duke vlerësuar se padia e ngritur nga subjektit zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (në vijim, referuar me shkronjat nistore PDIU), duhej të pranohej.

### *Faktet dhe rrethanat e çështjes*

PDIU u regjistrua si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 33, datë 05.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (referuar në vijim edhe si KSHZ).

Ky subjekt zgjedhor, si dhe dymbëdhjetë subjekte tjetrazgjedhore, kërkuan të regjistroheshin si koalicioni zgjedhor “Partia Demokratike – Alenaca për Ndryshim”, me shkronja nistore PD-AN, kërkesë e cila u miratua me vendimin nr. 107, datë 02.03.2021 të KSHZ. Partia udhëheqëse e këtij koalicioni është Partia Demokratike e Shqipërisë. Në marrëveshjen e koalicionit, ndër të tjera, në pikën 5 përcaktohet se: *“Autorizon z. IviKaso që, Të paraqesë kërkesë për regjistrimin e koalicionit së bashku me këtë marrëveshje në KQZ; Të përfaqësojë koalicionin gjatë procesit të shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit; Të caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KZAZ, KQV dhe në VNV në të gjithë vendin”*. Në vijim, rezulton se koalicioni PD – AN, ka depozituar edhe listat e kandidimit të pranuar nga KSHZ, për vijimin e garës për zgjedhjet për Kuvendin, që do të mbahen në datën 25.04.2021.

Në zbatim të nenit 95, paragrafi 2 dhe nenit 96, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, organizohet në seancë

publike hedhja e shortit, ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve.

**KSHZ me vendimin nr. 193, datë 31.03.2021, vendosi :**

- Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, është Lëvizja Socialiste për Integrim.

Në këtë vendim arsyetohet se :

“ ...

*Parti politike që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, jo më pak se dy mandate, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, janë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.*

*Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, si subjekt zgjedhor është anëtare/pjestare e koalicionit PD-AN dhe nuk ka paraqitur listë shumëemërore të vetën.*

*Bazuar në nenin 65, paragrafi 3, të Kodit Zgjedhor, përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit, si dhe marrëdhëniet midis partive partivepjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet në KQZ.*

*Për këto arsye, referuar nenit 2, paragrafët 2 dhe 3, të Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV”:*

- ... Nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim përmbush kriterin e numrit të mandateve, dhe i lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. **Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, si parti**

*e koalicionit zgjedhor PD-AN nuk legjitimohet të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve, për arsye se të drejtat e tij si subjekt janë përmbushur nga partia udhëheqëse e koalicionit (Partia Demokratike). ”*

**Kundër vendimit të KSHZ, PDIU paraqiti ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Ankesave (në vijim referuar si KAS), me të cilin kërkoi : “Ndryshimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe caktimin e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet për të marrë pjesë në shortin për anëtarin e katërt të GNV-së”. Në ankim u pretendua se : (i) argumenti mbi të cilin u mbështet Komisioneri në vendimin e tij, sipas të cilit PDIU nuk ka të drejtën e propozimit të numëruesit, sepse është pjesë e koalicionit, është i gabuar, pasi në marrëveshjen e koalicionit PD-AN, në asnjë rast nuk është shënuar ndonjë detyrim për t’u shmangur nga e drejta që ka si parti parlamentare e opozitës me më shumë se dy mandate për të caktuar një anëtar të GNV-së; (ii) vendimi nr. 193/2021 i KSHZ-së nuk është në përputhje me nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe parimin e baraspeshimit politik në përbërjen e Grupeve të Numërimit të Votave.**

**Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 20, datë 05.04.2021, vendosi:**

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.11, datë 02.04.2021 të subjektit ankues Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

**Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve e bazoi vendimin e tij në këtë arsyetim :**

“ ...

*2.Në momentin e regjistrimit të koalicionit PD-AN, ... subjekti ankues PDIU nuk mund të konsiderohet më në cilësinë e subjektit zgjedhor, duke qenë se këtë status tashmë e ka fituar koalicioni në të cilin PDIU bën pjesë. Ky argument përforcohet me faktin se PDIU nuk ka depozituar një listë të vetën shumemërore, nuk përfshihet në*

fletën e votimit me emrin dhe siglën e saj si parti më vete, por gjithmonë si pjesë e koalicionit PD-AN.

3. KAS vëren se sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor, regjistrimi i PDIU-së si koalicion zgjedhor së bashku me partitë e tjera, sjell si pasojë humbjen e së drejtës për të marrë pjesë në koalicion tjetër përveç atij ku është regjistruar, dhe gjithashtu humbjen e të drejtës për të paraqitur kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor me anë të ligjit nr. 118, datë 05.10.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 65 është shtuar pika e tretë, e cila parashikon se në momentin e regjistrimit të një koalicioni zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që përcaktohen nga Kodi Zgjedhor për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit ”.

4. Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje.

5. Me vendimin nr. 10, datë 06.06.2019, Kolegji Zgjedhor ka vendosur rrëzimin e padive të palëve paditëse PD dhe LSI, për shkak se nuk konsideroheshin subjekte zgjedhore. Interpretimi që Kolegji i bën termit “subjekt zgjedhor” në këtë vendim, është i tillë që përfshin: “ata subjekte të cilët në funksion të realizimit të programit të tyre, si dhe të prezantimit të pikëpamjeve të veta, është parashikuar të paraqesin edhe listat shumemërore të kandidatëve. (...) Pra është e dukshme se dy subjektet politike PD dhe LSI, përse nuk kanë paraqitur listë kandidatësh, mik kanë cilësinë e subjektit zgjedhor”.

Në analogji më çështjen në fjalë, as PDIU nuk mund të konsiderohet subjekt zgjedhor sipas interpretimit të Kolegjit Zgjedhor, sepse nuk ka depozituar lista të vetat shumemërore. Për më tepër, nëse i referohemi listave shumemërore që subjekti zgjedhor PD - AN ka depozituar në KQZ, kandidatë nga PDIU ka vetëm në 5 nga 12 zonat zgjedhore, më konkretisht në Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë dhe Vlorë, çka do të



thotë që në 7 zona të tjera zgjedhore, PDIU si parti politike, nuk ka asnjë interes në numërimin e votave çka është dhe kompetenca e GNV-ve. Ndaj interpretimi i KAS shkon dhe në përputhje me frymën e ratiolegis të neneve 95 dhe 96 të K.Zgjedhor.

...

8. Vendimi nr. 555, datë 26.07.2017 i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, ku numri i mandateve të fituara është si vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) 74 mandate;
- Partia Demokratike (PD) 43 mandate;
- Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) 19 mandate;
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) 3 mandate;
- Partia Social Demokrate e Shqipërisë (PSD) 1 mandat;

Mbështetur në rezultatin e mësipërm, KSHZ ka vendosur në vendimin nr. 193/2021 se partitë politike që kanë të drejtën e propozimit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-ve janë PS dhe PD, dhe si të tilla këto parti nuk renditen në listën e partive që do të propozojë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve. Nga partitë e shumicës, PSD nuk përmbush kriterin e numrit të mandateve, prandaj është PS që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve; ndërkohë që nga partitë e opozitës është LSI që ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve.

9. Në rastin konkret, duke marrë parasysh se në marrëveshjen e koalicionit të depozituar pranë KQZ-së nga partitë pjesëmarrëse të koalicionit PD-AN, në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje, është përcaktuar si parti udhëheqëse Partia Demokratike, automatikisht të gjitha të drejtat e rezervuara për partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni do të ushtrohen vetëm nga kjo parti udhëheqëse. Ndër këto të drejta, përfshihet edhe e drejta për të marrë pjesë në shortin për caktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve. Duke marrë parasysh se PD është partia që propozon nënkryetarin e KZAZ-ve, ajo ka të drejtën e propozimit të numëruesit të dytë të GNV-ve.

10. Bazuar në nenin 96, pika 1/1 të Kodit Zgjedhor: “nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt mik plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik”. Pra, hipotetikisht, edhe nëse PDIU do të pretendonte që e drejta e

propozimit të anëtarit të katërt ti kalonte PD-së si parti udhëheqëse e koalicionit, kjo gjë do të ndodhte vetëm nëse asnjë nga partitë e tjera të opozitës nuk do të përmbushnin kriterin e numrit të mandateve, por në rastin konkret, nga partitë e opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, LSI i përmbush kriteret e nenit 96, prandaj e drejta e propozimit të anëtarit të katërt kalon automatikisht te LSI.

11. KAS i gjen me vend parashtrimet e palës së interesuar, LSI, kur shprehet se PDIU nëpërmjet përfshirjes në koalicionin PD-AN, ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesëmarrëse duke deleguar të drejtat që mund ti ushtronte vetë kryesuesit të koalicionit/partisë udhëheqëse. Mungesa e saj në fletën e votimit, si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh për 12 qarqet, është tregues i qartë për tu marrë në konsideratë lidhur me faktin që PDIU që nga momenti i përfshirjes në një koalicion e ka humbur statusin e subjektit zgjedhor si dhe legjitimitimin e saj për të përfituar numërues në tavolinat e numërimit. Tashmë subjekt zgjedhor është Koalicionin PD - AN që ka depozituar listat shumëmemërore, pjesë e të cilave janë dhe kandidatë nga PDIU.

12. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues se në marrëveshjen e koalicionit nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur e drejta e partisë udhëheqëse për të marrë pjesë në short për caktimin e anëtarëve të GNV-ve, KAS arsyeton se marrëveshja e lidhur mes 12 partive pjesëmarrëse të koalicionit është një kontratë që sjell të drejta dhe detyrime për palët sipas vullnetit të tyre, por nuk mund të dalë kurrësi jashtë kornizës ligjore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Disa nga detyrimet që kjo kornizë ligjore përcakton janë: caktimi i një partie udhëheqëse; pjesëmarrja në zgjedhje nën emrin dhe logon e koalicionit dhe jo si parti më vete; depozitimi i listave shumëmemërore nga koalicioni dhe jo nga partitë më vete etj.

13. Fjalitë e dytë e pikës 3 të nenit 65 të K.Zgjedhor ku parashikohet se “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” është shteruese sa i përket të gjitha të drejtave që subjektet zgjedhore gëzojnë. Fakti që ligjvënësi nuk e ka ndryshuar nenin 96 të K.Zgjedhor në lidhje me të drejtën e partive për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, por ndërkohë, përjashtimisht për partitë politike pjesëtare të një koalicioni subjekt zgjedhor, ka ndryshuar pikën 3 të nenit 88 të K.Zgjedhor, që tashmë parashikon se “KQZ-ja përllëgarit shumën që i

*takon secilës parti, dake shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”, tregon qartë vullnetin e ligjvënësit për veçimin e një të drejte specifike siç është ajo e financimit të partive politike.*

### ***Procedura gjyqësore***

Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU), i'u drejtua Kolegjit Gjyqësor Zgjedhor me padi, duke ankimuar vendimin e KAS, mbi të njëjtat pretendime.

Kundrejt pretendimeve të palës paditëse, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, kërkuan rrëzimin e padisë, mbi argumentet ku u mbështet vendimi i KAS.

### ***Dispozitat e zbatueshme të Kodit Zgjedhor :***

Neni 1 Qëllimi dhe objekti

“1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet.

2. Në këtë Kod janë objekt i rregullimit: ... e) procedura e votimit dhe shpalljes së rezultateve; ...”

Neni 2 Përkufizime

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

...

12. “Parti parlamentare” është partia politike që ka fituar dhe zotëron të paktën një vend në Kuvend nga zgjedhjet pararendëse.

13. “Parti politike” është një parti e regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

14. “Përfaqësues i subjektit zgjedhor” është një person i autorizuar i subjektit zgjedhor për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore, në emër dhe për llogari të subjektit zgjedhor. ...

20. “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, ... të regjistruar në përputhje me këtë Kod. ...”

#### Neni 29 Përbërja e KZAZ-së

“1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) dy anëtarë propozohen nga *partia kryesore e shumicës parlamentare*, dy anëtarë propozohen nga *partia kryesore e opozitës parlamentare*, një anëtar propozohet nga *partia e dytë e shumicës parlamentare* dhe një anëtar propozohet nga *partia e dytë e opozitës parlamentare*. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në:

i) përzgjedhjen rastësore;

ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor; ...”

#### Neni 63 Subjektet zgjedhore dhe kandidatët

“1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod. ...”

#### Neni 64 Regjistrimi i partive politike në zgjedhje

“1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve. ...”

#### Neni 65 Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore

“1. *Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi* jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.

3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. *Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.* Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”

Neni 95 Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)

“...

2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi. ....”

Neni 96 Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve

“1. *Partitë politike* që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, *përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. ...”*

### ***Vlerësimi mbi çështjen në shqyrtim***

Referuar pretendimeve të palës paditëse, si dhe argumenteve mbi të cilat KAS vendosi të lërë në fuqi vendimin e KSHZ, lidhur me numëruesin e katërt të GNV-ve, personalisht vlerësoj sa vijon :

#### *(i) Mbi cilësinë e PDIU si subjekt zgjedhor*

Në seancën gjyqësore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, si KQZ, ashtu edhe LSI, pretenduan se pjesëmarrja e PDIU në koalicionin PD-AN dhe garimi me një listë të vetme tëkëtij koalicioni, pas sjell humbjen e cilësisë së PDIU-së si subjekt zgjedhor, sepse tashmë subjekt zgjedhor është vetëm koalicioni.

Lidhur me këtëçështje, vlerësoj se duhen mbajtur në vëmendje ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, të cilat përcaktuan se partitë politike mund të garojnë si subjekt zgjedhor më vete, apo duke u bashkuar në një koalicion. Në rastin e dytë, partitë politike nuk kanë të drejtën që të paraqesin listë kandidatësh të vetën, apo në një koalicion tjetër, të ndryshëm nga ai ku aderojnë. Mbi këtë bazë, ndërsa dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi regjistrimin e subjekteve zgjedhore nuk ndryshuan, vihet në diskutim nëse një parti politike e regjistruar si subjekt zgjedhor, e humbet këtë status nëse vendos të marrë pjesë nëzgjedhje në kuadër të një koalicioni.

Nisur nga fakti se më gjithë ndryshimin e bërë në Kodin Zgjedhor, lidhur me kandidimin e partisë politike në një koalicion, detyrimi i saj për tu regjistruar fillimisht si subjektzgjedhor në cilësinë e partisë politike vijoi të mbetet në fuqi, vlerësoj se aderimi i një partie pulitke të regjistruar si subjekt zgjedhor, në njëkoalicion, nuk i heq asaj cilësinë e subjektit zgjedhor. Në këtë rast, ky subjekt vendos tëkandidojë së bashku me disa parti të tjera, që përbëjnë koalicionin, duke paraqitur të njëjtat lista kandidatësh. Referenca e KQZ në një vendim të Kolegjit Zgjedhor, lidhur me cilësinë e një partie politike si subjekt zgjedhor, duke iu referuar listës së kandidatëve, vlerësoj se është jo relevante, pasi në atë rast partia politike nuk ishte regjistruar si subjekt zgjedhor, ndaj nuk bëhej fjalë fare për listë kandidatësh të saj. Po ashtu, situata i përket një periudhe kur nuk ishin miratuar ndryshimet aktuale të Kodit Zgjedhor. Për rrjedhojë, PDIU sikurse edhe partitë e tjera të koalicionit PD-AN (përfshirë partinë udhëheqëse të koalicionit, PD), vijnë të mbajnë cilësinë e

subjektit zgjedhor për sa kohë që janë regjistruar si të tilla dhe figurojnë në regjistrin e subjekteve zgjedhore.

***(ii) Mbi të drejtat dhe detyrimet e partisë pjesëmarrëse në koalicion***

Argumenti bazë, mbi të cilin ankimi i PDIU ndaj vendimit të KSHZ-së, nuk u gjet i bazuar nga ana e KAS, mbështetet në paragrafin e tretë të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, të shtuar me ndryshimet e fundit, sipas të cilit “*Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit*”. Mbi këtë dispozitë argumentohet se edhe të drejtat që lidhen me numërimin e votave, do të përmbushen nga Partia Demokratike udhëheqëse e koalicionit.

Rezulton se PD ka të drejtën si partia më e madhe e pakicës parlamentare të propozojë numëruesin e dytë dhe sipas KQZ ajo përmbush edhe të drejtat e PDIU, pjesëtare në koalicion, lidhur me këtë proces (numërimin e votave).

Vlerësimi i mësipërm i KAS nuk duket se gjen mbështetje në Kodin Zgjedhor, ndërsa interpretimi i dispozitës për rastin në shqyrtim, çalon.

Nëse pranohet ky interpretim i Kodit Zgjedhor, atëherë e drejta e PDIU-së për të propozuar numëruesin e katërt mund t'i njëhej PD-së, ndërsa të dyja këto parti do të duhej ta kishin rregulluar me marrëveshje se si do ta propozonin këtë numërues. Në fakt, e drejta që pranohet se i përket PDIU-së nuk i është njohur PD-së si partia udhëheqëse e koalicionit dhe përfaqësuese e tij pranë KQZ-së, duke gjetur një zgjidhje që e mohon këtë të drejtë qoftë për PDIU-në si subjekt zgjedhor dhe parti politike që përmbush kushtet për të bërëpropozimin, qoftë për koalicionin ku ajo bën pjesë dhe që mund të ushtronte, nëpërmjet partisë udhëheqëse të drejtat e PDIU-së. Në këto kushte, është e paqartë se si PDIU do ta përmbushë të drejtën e saj për propozimin e numëruesit të katërt.

***(iii) Mbi pretendimin për propozimin e numëruesit të katërt***

Pretendimi i PDIU-së për hedhjen e shortit për partitë politike që do propozojnë numëruesin e katërt, vlerësoj se është i bazuar.

Grupet e Numërimit të Votave janë pjesë e administratës së ulët zgjedhore. Duke i'u referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe posaçërisht ndryshimeve të fundit në këtë Kod, rezulton se organet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KSHZ dhe KAS), zgjidhen nëpërmjet procedurave dhe mbi bazën e kriterëve, që synojnë të garantojnë pavarësinë e tyre nga faktorët politikë në përgjithësi dhe subjektet zgjedhore në veçanti. Nga ana tjetër, ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk prekën nivelin bazë të administratës zgjedhore, duke e lënë krijimin e saj sipas rregullimit ekzistues para ndryshimeve. Në këtëkuptim, si Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), si Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), ashtu edhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV), ngrihen sipas të njëjtës formulë. Në bazëtë kësaj formule qëndron rezultati në zgjedhjet pararendëse të partive parlamentare. Sipas kësaj logjike, ligjvënësi u beson organet bazë të administrimit zgjedhor, atyre partive politike, të cilat janë votuar më shumë nga zgjedhësit, referuar për këtë si shumicës ashtu edhe pakicës parlamentare, me synimin e balancimit të preferencave të zgjedhësve. Kjo do të thotë se çdo parti parlamentare, që plotëson kushtet e parashikuara në ligj për të propozuar anëtarë të këtyre organeve, e fiton këtë të drejtë vetëm për shkak të votimit nënjë masë të caktuar nga zgjedhësit. Në rastin e GNV-ve dhe mënyrës së përcaktimit të numëruesve të tretë e të katërt, neni 96 i Kodit Zgjedhor u referohet partive të shumicës dhe pakicës parlamentare, të ndryshme nga partitë më të mëdha të tyre (ato kanë të drejtën e propozimit të numëruesve të parë e të dytë). Në rastin në shqyrtim, sikurse pranohet nga të gjitha palët, referuar kësaj formule, e drejta për propozimin e numëruesit të katërt u takonte LSI-së dhe PDIU-së, si partitë e pakicës parlamentare që plotësonin kushtin ligjor (të kenë të paktën dy mandate).

Duke i'u kthyer argumentit të KAS, sipas të cilit

- e drejta e PDIU, sikurse të drejtat e tjera të saj si parti pjesëtare e koalicionit PD-AN, përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit (PD);
- kur kjo e fundit ka të drejtën e propozimit të numëruesit të dytë, si partia më e madhe e pakicës parlamentare
- e drejta për të propozuar numëruesin e katërt i përket vetëm LSI-së;

vlerësoj se vendimi i KAS nuk bazohet në Kodin Zgjedhor.



Së pari, parashatroj qëndrimin se me ndryshimet në Kodin Zgjedhor kur pjesëmarrja në zgjedhje me koalicion të partive, i ndalonte këto të fundit tëparaqesin listë kandidatësh, të ndryshme nga ajo e koalicionit, lindte nevoja për të rregulluar edhe dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor për ti përshtatur ato konform këtij ndryshimi të rëndësishëm. Në fakt, nuk ndodhi kështu dhe shumë dispozita mbetën të pandryshuara, pavarësisht nevojës së sipërcituar. Të tilla janë edhe dispozitat mbi kompozimin e administratës bazëzgjedhore, në të cilat Kodi referon tek konfigurimi i partive në parlament, referuar mandateve që secila prej tyre ka fituar në zgjedhjetpararendëse. Ky formulim nuk paraqiste asnjë problem para ndryshimeve, kur partitëpolitike garonin me listat e tyre dhe njëkohësisht formonin edhe koalicionet zgjedhore (nuk kishte një listë të koalicionit). Për rrjedhojë secila parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje, llogariste mandatet e saj në Kuvend, duke bërë të mundur edhe aplikimin e formulës për ngritjen e KZAZ-ve, KQV-ve e GNV-ve. Nga ana tjetër, me ndryshimin e rregullave për pjesëmarrjen në zgjedhje me koalicion tëpartive, është praktikisht e pamundur që të evidentohen pas zgjedhjeve, votat dhe mandatet që ka marrë secila parti pjesëtare e koalicionit, pasi mandatet do të llogariten për vetë koalicionin dhe listën e përbashkët tëpartive. Mbi këtë bazë formula për ngritjen e organeve të mësipërme, paraqet problem për zbatimin nëpraktikë, duke qenë se referenca vijon të mbetet tek numri i mandateve, që ka marrë secila parti e shumicës apo pakicës parlamentare, edhe në rastin kur ato kanë qenë pjesëtare në koalicion.

Gjithsesi përtej problematikës lidhur me ometimin ligjor për rregullimin e kësaj situatë, dispozita duhet të interpretohet dhe zbatohet në frymën e ligjit, ndaj çështja nëse e drejta e PDIU-së për të propozuar anëtarine katërt të GNV-ve përmbushet apo jo nga PD-ja, si partia udhëheqëse e koalicionit, merr rëndësi.

Nëse do të pranohej interpretimi i ligjit sipas KAS, një sërë hipotezash do të mbeteshin pa zgjidhje, duke krijuar bindjen se vendimi objekt ankimi nuk gjen mbështetje në ligj.

Disa nga situatat dhe pyetjet që mund të ngriheshin janë :

(i) Nëse PDIU nuk është subjekt zgjedhor, sepse nuk ka paraqitur listë kandidatësh dhe garon në një koalicion, po PD a është subjekt zgjedhor?

(ii) Nëse PD nuk është subjekt zgjedhor, përse i'u njoh e drejta për të propozuar numëruesin e dytë, si partia më e madhe e pakicës parlamentare?

(iii) Nëse e drejta e PDIU për të propozuar anëtarin e katërt përmbushet nga PD, si partia udhëheqëse e koalicionit, përse nuk u caktua PD për të marrë pjesë në shortin përkatës?

(iv) Nëse PD nuk do të ishte partia udhëheqëse e koalicionit, a do t'i njëhej e drejta PDIU për të marrë pjesë në shortin për propozimin e numëruesit të katërt?

(v) Nëse edhe LSI do ishte pjesëmarrëse në koalicion, si do të zgjidhej situata lidhur me këtë të drejtë?

(vi) Nëse të gjitha partitë politike parlamentare që përmbushin kushtet ligjore për të propozuar numëruesit (të katërt) do të ishin në një koalicion, si do të përcaktoheshin ato?

Këto pyetje dhe të tjera, tregojnë se interpretimi i ligjit nga KAS nuk bind, sepse më gjithë ndryshimet në Kod, e drejta e partive parlamentare për të propozuar anëtarët e GNV-ve nuk pësoi ndryshim, ndaj rregulli ekzistues duhet të zbatohet duke shmangur zgjidhje që në thelb bazohen në rregulla të pacaktuara me ligj. Mohimi i së drejtës së PDIU, vetëm për shkak të pjesëmarrjes së saj në një koalicion ku nuk është parti udhëheqëse, nuk është i bazuar. Nëse mbahet qëndrimi që partitë e koalicionit nuk janë subjekte zgjedhore, atëherë edhe PD nuk është subjekt zgjedhor e mbi këtë bazë numëruesi i dytë do të duhej të ishte caktuar nga koalicioni dhe jo nga PD-ja. Në fakt ky arsyetim nuk qëndron, pasi vetë ligji nuk u jep të drejtën koalicioneve për të propozuar numëruesit e GNV-ve por partive politike parlamentare. Në këtë kuptim, disponimi prej PDIU i dy mandateve, si parti e pakicës parlamentare, është elementi i vetëm dhe i mjaftueshëm për ta përfshirë atë në hedhjen e shortit për të përcaktuar numëruesin e katërt. Mohimi i cilësisë së saj si subjekt zgjedhor, ndërkohë që nuk mbahet i njëjti standard me PD, si partia udhëheqëse, tregon defektin e këtij interpretimi, ndërsa nëse do të zbatohet rregulli i nenit 64.3 i Kodit Zgjedhor, mbi të drejtat dhe detyrimet e partive pjesëtare në koalicion, kjo nuk duhet të çojë në mohimin e së drejtës së njohur nga vetë ligji. Është e vërtetë se dispozita e nenit 96 nuk reflekton ndryshimet e Kodit Zgjedhor, lidhur me koalicionet zgjedhore, por për sa kohë që rregulli është i qartë dhe referon vetëm në pozitën në Kuvend të partive dhe numrin e mandateve të tyre (referuar zgjedhjeve pararendëse), ai duhet të zbatohet ashtu sikurse është shkruar, pa interpretime që vënë në dyshim parimin mbi të cilin

është bërë kjo zgjedhje nga ligjvënësi, barazpeshimi politik në administratën bazë zgjedhore, si dhe besimin tek partitë që kanë arritur një sukses të caktuar në zgjedhje. Referuar pikërisht rolit që partitëpolitike kanë në një shoqëri demokratike dhe kontributit që ato japin në procesin e zgjedhjeve, është pranuar nga ligjvënësi që edhe organet qëadministrojnë procesin e votimit, të ngrihen mbi bazën e propozimeve që vijnë pikërisht nga partitë që kanë treguar se gëzojnë një farë mbështetje nga zgjedhësit, duke i'u referuar pikërisht numrit tëmandateve të fituara në Kuvend.

Nisur nga sa më lart,

- për sa kohë që neni 96 i Kodit Zgjedhor, në lidhje edhe me nenin 183.8 të Kodit Zgjedhor (dispozitë kalimtare), caktojnë të njëjtën formulë për propozimin e numëruesit të katërt;
- kushti i vetëm për të propozuar anëtarin e katërt për partinë e pakicës parlamentare është fitimi i dy mandateve në Kuvend në zgjedhjet e vitit 2017;
- PDIU është parti parlamentare e pakicës dhe ka fituar dy mandate në zgjedhjet e vitit 2017;

vlerësoj se ajo kishte të drejtën që të merrte pjesë në shortin për propozimin e anëtarit të katërt të GNV-ve. Për këtë arsye jam e mendimit se padia duhej të ishte pranuar.

**Tiranë, 19.04.2021**

**Gjyqtare në pakicë**

**Edlira PETRI**